VENDIM
Nr. 66, datë 27.5.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E "KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË"

Në mbështetje të nenit 16; nenit 79 dhe 94 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe nenit 25, të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin e "Draftkushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë", të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti